

Ftesë për pjesëmarrje në Konferencën Shkencore: “Luigj Gurakuqi në Rilindjen Kombëtare dhe në Periudhën e Shtetndërtimit”.

I/e nderuar,

Kemi kënaqësinë t’ju ftojme të merrni pjesë në Konferencën Shkencore: **“Luigj Gurakuqi në Rilindjen Kombëtare dhe në Periudhën e Shtetndërtimit”**, e cila organizohet nga Instituti i Historisë “Ali Hadri” në bashkëpunim me Akademinë e Shkencave të Shqipërisë-Institutin e Historisë-Tiranë. Konferenca do të mbahet më 23 tetor 2026 në Prishtinë.

Tezat e konferencës:

- Luigj Gurakuqi në fazën e fundit të Rilindjes Kombëtare.
- Qëndrimi i Luigj Gurakuqit ndaj Kryengritjes së vitit 1911.
- Luigj Gurakuqi intelektual, politikan e diplomat.
- Kontributi i Luigj Gurakuqit për arsimin kombëtar.
- Pjesëmarrës i Kongresit të Manastirit dhe drejtor i Normales së Elbasanit.
- Karriera e Luigj Gurakuqit në postet ministrore në qeveritë shqiptare.
- Bashkëpunimi i Luigj Gurakuqit me personalitete të shquara kombëtare si: Ismail Qemali, Hasan Prishtina, Fan Noli, Gjergj Fishta, Faik Konica, etj.
- Kontributi i Luigj Gurakuqit në letërsi.
- Qëndrimi i Luigj Gurakuqit ndaj Italisë dhe Austrisë.
- Qëndrimi i Luigj Gurakuqit ndaj përçarjeve politike ndërshqiptare.
- Emigrimi i Luigj Gurakuqit në Itali.
- Vrasja e Luigj Gurakuqit.
- Trajtimi i figurës së Luigj Gurakuqit në studime, monografi, arte dhe tekste shkollore.

Afatet për dorëzimin e abstrakteve dhe kumtesave të plota:

- Afati për dorëzimin e abstrakteve: 31 mars 2026, në adresën e emailit: instituti.historis@rks-gov.net
- Njoftimi për pranimin e punimeve: 10 prill 2026.
- Afati për dorëzimin e punimeve të plota më 23 tetor 2026, me rastin e prezantimit të kumtesës në Konferencë.

Kumtesat dhe rezultatet e kërkimeve shkencore të pjesëmarrësve në Konferencë do të botohen në përmbledhje të veçantë.

Për informacion shtesë ju lutemi të na kontaktoni në adresën e emailit:
instituti.historis@rks-gov.net

Me respekt, Teuta SHALA-PELI
Drejtoreshë e Institutit të Historisë “Ali Hadri”.